

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Hoqën dorë nga Franca, Italia dhe Tirana për të zhvilluar bizneset në Koman dhe Pogradec, Rama na pr ezanton me 3 sipërmarrësit
ADRESA	https://newsbomb.al/aktualitet/hoqen-dore-nga-franca-italia-dhe-tirana-per-te-zhvilluar-bizneset-ne--i401658
BURIMI	newsbomb.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	20 shtator 2026, 09:08:23 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	20 shtator 2026, 09:00:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	e364e7c5a0e8f8c62ca46a334f148e741a172aedef5cd4504efcbcacb130f60b8
TEKSTI	587b82c40fb9b2bd56383cdb78d11717104045376e4f52b180051138ee587213
PAMJA	98fc08e55f290c88b829ce18a8e57cd1ba75dd07d120e227594cd9e51f44679a

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	f23982d01e8dde30f208b850d2ed76e1c0d71d6decfba1e7631c143afab25d45
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	7843691d73f82da58f46c5c712d0bec6679deb0584938ea073db401557569169
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/f23982d01e8dde30f208b850d2ed76e1c0d71d6decfba1e7631c143afab25d45>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

12 numrat e parë FALAS!
Version PDF

Abonohu te Revista

Kreu Politikë Aktualitet Ekonomi Kulturë & Art Rajon Sport Bota Showbiz SocialBomb



Çështjet kryesore

Haga vendos për katër ish-krerët e UÇK-së!

Arrestohet Ergys Agasi

"Retreat"-i i qeverisë në Pogradec!

Aktualitet

20 Shtator 2026, 11:00

Hoqën dorë nga Franca, Italia dhe Tirana për të zhvilluar bizneset në Koman dhe Pogradec, Rama na prezanton me 3 sipërmarrësit



Shkruar nga Newsbomb



Edi Rama dhe 3 sipërmarrësit Entela, Kisi, Taulanti

Në podcastin e sotëm "Flasim", kryeministri Edi Rama kishte të ftuar sipërmarrës shqiptarë Taulantin nga Pogradeci, Entelën dhe Kisin nga Koman, të cilët së bashku me familjet e tyre kanë zhvilluar bizneset e tyre familjare në vendlindjet e tyre, vende që falë investimeve të bëra ndër vite kanë ndikuar pozitivisht në ecurinë e sipërmarrjeve të tyre.

Pas disa viteve në zemër të kryeqytetit shqiptar, Entela e cila ka qenë e punësuar në një nga administrata publike, zgjodhi që të zhvendosej në veri, në Koman, në vendlindjen e burrit të saj Sokolit. Dyshja që sot janë bërë dhe gjithë nisën biznes familjarë duke ofruar strehim për turistët në Koman, ndërsa synojnë që të zhvillojnë sipërmarrjen e tyre dhe me anë të "Paketës së Maleve" dhe projektit "Dyfisho Sipërmarrjen tënde", që iu sugjerua dhe nga kryeministri Rama.

Duke vijuar më tej me dëshirën e saj për të jetuar në Komanin e bukur i cili sot është shndërruar në një

"Truallin që ata nuk e kontestojnë, duhet të merrni lejen me projektin përkatës së zhvillimit, mund të ndiqni rrugën e "Paketës së maleve" Plus që keni mundësinë që me atë rrugë të përfitonit dhe nga kredia e lehtësuar e dyfishimit sipërmarrës" i tha Rama Entelës.

"Në fakt e kemi menduar, e tani që jemi rehat, sepse rehatia vjen nga puna" shtoi Entela.

Revista



Abonohu tani dhe lexoje >

Lajmet e fundit



Foto e Ditës

Arbëreshët dhe shqiptarët bashkohen në një mesazh për Kosovën



Bota

A mund ta zhdukë inteligjenca artificiale njerezimin? Skenarët e tmerrshëm dhe mosmarrëveshja e madhe midis ekspertëve

Zbuloni më shumë artikuj >

"Jeni rehat sepse rehatia nuk helmoheni me lajmet e ditës që janë 90% rrena" shtoi Rama.

Tre biznesmenë të cilët falë mbështetjes së familjeve të tyre kanë arritur të shënojnë sukses ndër vite dhe falë investimeve dhe punës së bërë në Shqipëri, kanë të njëjtin synim: zhvillimin e mëtejshëm të bizneseve të tyre. Edhe pse ndër vite ata kanë emigruar duke tentuar për të siguruar një jetesë më të mirë jashtë shtetit, zemra e tyre i përkiste Shqipërisë, aty ku dhe jetojnë familjarët e tyre me të cilët sot ata kanë arritur të krijojnë bizneset e veta, që dita-ditës po zhvillohen.



Edi Rama: Sot me Taulantin që ka shkruar nga Pogradeci, Entela nga Komani dhe një tjetër letërkthar nga Komani që është Kisi i cili është më i riu këtu. Ndryshe nga dy të tjerët, ai vjen direkt nga emigracioni në lirinë e natyrë. Ndërkohë që Taulanti ka bërë një rrugë më të gjatë, e Entela nga ana tjetër është shpërngulur nga gjurmët e Tiranës në Komanin magjepsës.

Entela: Burri im Sokoli, që jemi njohur në shkollë, e kam nga Komani. Unë jam rritur e lindur në Fier, babi në fakt nga Saranda dhe mami është labe. Tani unë e Sokoli jemi gjyshër. Pasi mbaruam shkollën jetuam në Tiranë, në një apartament me qera, deri në 2015. Punonim, Sokoli vazhdonte punën me atë sistemin katër ditor. Ndërsa unë punoja në administratë. Ne nuk dolëm kurrë jashtë vendit. Jetuam në Tiranë. të shtunave dhe të dielave shpërngulemi në Koman, nuk e kemi braktisur kurrë atë vend.

Pa e ditur që Komani do bëhej një pikë turistike. Sokoli është djali i vetëm i familjes dhe e do fort. Ma ka injektuar dhe mua atë dashuri, më ka bërë ta dua dhe unë. Në 2015 vendosëm që të shkëputesha dhe të shkoja dhe unë atje. Duhet pranuar jo me ndonjë dëshirë të madhe. Sepse duhet punuar toka, ka punë. Më vonë, në 2017 po flitje për lumin e Shalës, menduam të punonim në fillim vetëm me telefonata. Sot kemi një bujtinë, që është shtëpia ekzistuese ku ka lindur Sokoli. Në Koman ka ndërtesa shumë të vjetër hidrocentrale që shumë deshën ti shkatërronin.

Nuk mendonim kurrë që do të vinte ëndrra e sezonit. Është living room, ka një dhomë, në dhomën e gjumit kapaciteti i apartamenti është gjashtë persona. Në 3 apartamente shtëpia pret thuajse 12 ose më shumë. Në momentet kur njerëzit mbesin jashtë, ne duhet të hapim derën.

Taulanti: Pogradeci është shumë mirë, nga mesi i korrikut patëm pak luhatje por tani është mirë. Shkoi për studime në Itali në 2002, kur të gjithë shkonin për punë, pa ditur njeri, kënaqesha kur dyert hapeshin vetë. Me kalimin e kohës kam bërë shkollën e lartë atje në Romë. M'u desh shumë kohë që të përshtatesha nga Roma në Shqipëri. Doja të kthehesha, dëgjoja juve për vizionin që kishit për Shqipërinë asokohe. Unë jam këtu tani, vazhdoj dhe punën e prindërve të mi.

Tani familjarisht vazhdojmë punën e përpunimi të qumështit. Ndërmarrja është rritur. Kur erdha në fillim, në 2014 ishim tetë punonjës deri në 10. tani jemi 35 punonjës e deri në 400 fermerë që bashkëpunojmë. Ndryshova teknologjinë. Punonjësit nuk e shikonin të arsyeshme që gjërat me touch do të bënin punën e njeriut. Unë nuk i tremben testeve që do të bëhen për të kaluar në BE.

Më është dashur tre herë të flisja për vizionin tim që kisha për baxhon e prindërve. të parin e kalova pa BE, i dyti ishte kategorizimi tani. Vështirësia e vetme ishte të punonim pak me fermerët, të cilët duhet të përshtaten me standartet, se ai djathë që bëj unë duhet të jetë i mirë.

Kisi: Te tatuazhi është "Shën Mhilli" kam dhe kryqin, e kam bërë këtu ka nja tre vite, e kam bërë në Shkodër.

Çdo gjë nisi nga dashuria e prindërve të mi që kishin për të më mbajtur mua afër dhe nga dashuria që kisha unë për Komanin. Aty filluam me një bar kafe të vogël. Kam qenë nja dy herë në emigrim, e kam bërë provë. Shkova në Francë, kisha disa shokë atje, të shikoja se si funksiononte. Ishte bukur me thënë të drejtën, por çdo gjë e shtrenjtë. Por si vendi yt nuk ka .

Ndejta nja dy javë, më tepër s bëhej llaf. problemi është se isha djali i vetëm i familjes, e nuk kishte shanse t'i lija vetëm ata. Ne na krijuar mundësia e turizmit në Koman. Kur u ktheva, ngritëm një bar kafe, dhe një kamping të vogël. Punoj me familjen, kam mamin, babain, motrën dhe gjyshen. Punojmë të gjithë bashkë, jemi super mirë. Tani që është bërë dhe rruga jemi shumë mirë. Franca që ishte ëndrra ime dikur tani i kam vendosur kryq. Pas dhjetë vitesh, me ndihmë të zotit shumë të zgjeruar e pse jo të kem një shtëpi mikpritje, t'ju tregojmë anën tonë më të mirë. Ata mbarojnë kur shohin se në një biznes punojnë familjarisht.

Sondazh

Poll

Lexo gjithashtu



🕒 E Diel 10:47

DEL FOTO: Ky është "Tani i Ruzhdiut", 44-vjeçari që u qëllua me breshëri plumbash në Sarandë, vjet u arrestua për plagosjen e Lamajt



Aktualitet

"O bir i nënës...", ja kush është 44-vjeçari që ra pre e atentatit në Sarandë, u vra para syve të së ëmës (PAMJE-DETAJE)

🕒 E Diel 10:16



Aktualitet

"Kërcet" arma në Sarandë, raportohet për një viktimë, plumbat kapin dhe një kalimtar të çastit, detajet e para

🕒 E Diel 10:05 Newsbomb



GJIROKASTËR



E Diel 09:58

Autobusi plot me mallra kontrabandë, sekuestrohen 22 mijë euro në Gjirokastrë, prangosen dy persona



Aktualitet

Dënohen me burg dy shqiptarët në Britaninë e Madhe, u kapën duke kultivuar drogën që do të shitej deri në 400 mijë paund



Aktualitet

Pagat e magistratëve: A luftohet paligjshmëria me paligjshmëri?!

E Diel 09:32

E Diel 09:41



E Diel 08:38

Revista Newsbomb.al vjen me numrin e ri, nga sot në të gjitha pikat e shitjes! Ja artikujt që do të lexoni



Aktualitet

Uljë temperaturash dhe reshje të dendura shiu, zërat ku duhet të keni



Aktualitet

Pristina protestoi edhe sot për eliminimet, emigrantët u mbledhën

demokracia shpirtë, zonat ku duhet të kemi
çadrën me vete

E Diel 07:03

qumitaret, emigrantet e mercenierët
në Europë

E Shtunë 22:56



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.